



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 1605, datë 10.12.2008

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE NË KOMUNËN KALLMET,
TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 8, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:


1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të komunës Kallmet, të qarkut të Lezhës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 285 (dyqind e tetëdhjetë e pesë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA


MINISTRI I BRENDSHËM

BUJAR NISHANI

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

FERDINAND PONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 725 , datë 1.7.2009

P Ë R

**MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN,
NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KALLMET, TË
QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kallmet, të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Kallmet, të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.1605, datë 10.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kallmet, të qarkut të Lezhës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kallmet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM



BUJAR NISHANI

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1 - 6	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
7 - 11	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
12 - 33	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
34 - 38	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e Strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
40 - 41	Varrezat publike.	Në pronësi
43 - 67,69 - 116	Infrastrukturë (Rrugë vendore).	Në pronësi
118 - 128	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës - kanalizimeve.	Në pronësi
235 - 246	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
234,247 251,255,259,262,267	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta).	Në pronësi


 MINISTRI

Bujar NISHANI

